

Bashkelidhur po ju dergojme informacionin e kerkuar mbi procedurat e prokurimit te zhvilluara deri tani per vitin 2017, me konkretisht

- i) listen e kontratave të lidhura;
- ii) shumën e kontraktuar;
- iii) palet kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo malirave të kontraktuara;

Referuar rubrikes iv) Informacionin per zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika td ndryshme; ju bejme me dije se monitorimi dhe zbatimi I kontratave te nenshkuara nuk ndiqet dhe zbatohet nga Sektori I Prokurimeve.

| Nr. | Emërtimi i procedurës Viti 2017 | Kontraktuesi | Lloji i Procedures | Vlera Kontrates lekë (me tvsh) |
|------------|---|--|---------------------------|---------------------------------------|
| 1 | Mirembajtje dhe zhvillim i sistemit ICMIS, 2 vjet e 3 muaj. | “ikubINFO” sh.p.k | Procedure e Hapur | 11,909,184 |
| 2 | Përmirësimi i sistemit të mbikqyrjes elektronike në fushën penale, 4 vjet e 1 muaj. | BOE “Soft Solution” sh.p.k dhe, “Fastech” sh.p.k dhe “Ratech” sh.p.k | Procedure e Hapur | 233,952,000 |
| 3 | Ri-konceptimin, përmirësimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarimit ALBIS, 4 vjet e 3 muaj. | BOE “Soft Solution” sh.p.k dhe “Fastech” sh.p.k | Procedure e Hapur | 67,080,000 |

Referuar pikes 7h te tabelës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit Sektori I Arkiv-Protokollit, mbledhë përpunon, administron, ruan dhe shërben pasurinë arkivore të mbrojtur dhe siguruar nga shteti (neni 1, pika 1 të ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”). Administrimi i informacionit të ardhur pranë aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, bëhet në dosjet përkatëse sipas zerave. Shfrytëzimi i arkivave në funksion të njohjes me veprimtarinë e administratës shtetërore dhe e drejta për shërbim me dokumente bëhet për qëllime studimore-shkencore ose për nevojat vetjake. Administrimi i dokumenteve bëhet sipas afatëve për përcaktuar në ligj, sipas kategorisë së klasifikimit të dokumentit. Përcaktimi i vlerës dhe i afatëve të ruajtjes së dokumenteve të arkivave, bëhet nga komisioni i ekspertizës, pranë institucionit (neni 7 pika 1 të ligjit “Për Arkivat”). Në kreu VII të ligjit nr.9154, dt.06.11.2003 “Për Arkivat” shprehet qartazi komunikimi dhe shfrytëzimi i dokumentacionit të fondit kombëtar. Dokumentet që përmbajnë të dhëna me karakter vetjak dhe cenojnë jetën intime të personit ndalohej njohja dhe publikimi i dokumentacionit. Kërkesat për shfrytëzim dokumentesh, jo në të gjitha rastet pranohet duke qenë se për të vënë në dispozicion një informacion të klasifikuar në kategorinë “sekret shtetëror” është i kufizuar me ligj për personat e paautorizuar, pasi “eksponimi i paautorizuar” mund të sjellë dëm serioz sigurisë kombëtare, bazuar në nenin 3 të ligjit nr.8457, dt.11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”. Përfundimisht për të drejtën e njohjes së informacionit kanë vetëm institucioni/personi të cilit me ligj i është deleguar një e drejtë e tillë sipas nenit 21, të ligjit nr.8457, dt.11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”. Një institucion nuk mund të zbulojë informacionin origjinal të klasifikuar nga një institucion i huaj pa autorizimin e këtij të fundit.

,